

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Amendamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Nxënësit (PPRA) mbi Njoftimin dhe Miratimin/Përrjashtimin nga Aktivitete Specifike 2013-14

Amendamenti për Mbrojtjen e të Drejtave të Nxënësit (PPRA) 20 U.S.C. § 1232h kërkon që Drejtorja Arsimore e Filadelfias të njoftojë dhe të marrë pëlqimin tuaj, ose t'u lejojë që, fëmija juaj të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitete të caktuara shkollore. Këto aktivitete përfshijnë anketime, analiza, ose vlerësime të nxënësit, që do të kenë të bëjnë me një ose disa, nga tetë fushat e mëposhtëme (“anketime/pyetsor ku informacioni është privat, i mbrojtur”):

1. Anëtarësimi politik ose fetar i nxënësit, ose prindit të tij;
2. Problemet mendore, ose psikologjike të nxënësit, ose familjes së tij;
3. Orientimi apo sjellja seksuale;
4. Sjelljet ilegale, jo shoqërore, përfshirja në krime, ose sjelljet e ulëta;
5. Vlerësimet kritike të të tjerëve, me të cilët ka marrdhënie familjare;
6. Marrdhëniet e privilegjuara legale, me njerëz si juristë, doktorë, ose pastorë/shërbyes;
7. Praktikrat fetare, anëtarësimet, ose bindjet fetare të nxënësit apo prindit; ose
8. Të ardhurat familjare, veç atyre që i përmban ligji për të përcaktuar të drejtën për të hyrë në program.

Këto kërkesa gjithashtu aplikohen në mbledhjen, lëshimin, ose vënien në përdorim të informacionit të nxënësit për qëllime marketimi (“anketim marketimi”), dhe ekzaminime apo analiza të caktuara fizike të nxënësit.

Nëse dëshironi të rishikoni çdo dokument të anketimit, ose materialin udhëzues të përdorur në lidhje me çdo informacion mbrojtës, ose anketimin e marketimit, ju lutemi paraqesni kërkesën në shkollën që ndjek fëmija juaj. Drejtori i shkollës do t'ju njoftojnë për kohën dhe vendin, ku ju të rishikoni këto materiale. Ju keni të drejtë të rishikoni anketimin dhe/ose materialin udhëzues përpara se ky pyetsor të zhvillohet për nxënësin.

Nëse dëshironi ta përjashtoni fëmijën tuaj nga pjesëmarrja në këto anketime, ju lutemi plotësoni formën poshtë dhe kthejeni atë në shkollën e fëmijës suaj. Nëse, nuk vendosni që fëmija juaj të përjashtohet nga këto anketime, ju përsëri keni të drejtën të rishikoni çdo formë anketimi, ose materialin udhëzues, që shkolla do të përdorë në këtë anketim. Nëse ju nuk e ktheni formën e mëposhtëme, ju miratoni pjesëmarrjen e fëmijës suaj në këto anketime.

Unë _____, NUK JAP miratim për fëmijën tim _____ të marrë pjesë në anketimet, analizat, ose vlerësimet e nxënësit, që kanë të bëjnë me një ose disa nga fushat në listën e mësipërme të këtij dokumenti.

Emri i nxënësit (me shtyp)

Firma e prindit

Numri i ID-së së nxënësit

School #/Numri i shkollës

Ju lutemi, kthejeni këtë formë jo më vonë se 20 dhjetor 2013 tek drejtori i shkollës së fëmijës tuaj.

Për informacione dhe dokumenta të tjerë të përkthyer në Gjuhën Shqipe, ju lutemi vizitoni uebsajtin:

www.philasd.org/language/albanian